



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE	
Nr. Prot./Prot.Br./Prot.No.	544
Njësi/Jedinita/Unit	KSH
Nr. Shkres./Lpis.Br./Reg. No.	02.11.2012
Datë/Datum/Date	02.11.2012
PRISHTINË - PRISTINA - PRISHTINA	

Prishtinë: 02. 11. 2012
Referenca: KSH/01/2012

KOMISIONI SHQYRTUES

Komisioni Shqyrtues në përbërje të:

1. Ylber Aliu, Kryesues
2. Bekim Gola, Anëtar
3. Hysni Feka, Anëtar

Në çështjen e ankesës së:

Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë (më tutje: KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë), ankesë e bërë me datë: 09. 10. 2012, me Nr 499, me temë: *Ankesë për Llogaritjen e Paushallit.*

Kundër vendimit të:

Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (më tutje: ZRRUK), datë 27. 08. 2012, për aprovimin e procedurave interne për aplikim nga KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë, për faturim të konsumatorëve pa ujëmatës, ose me ujëmatës jo funksional, si dhe, letrës së dërguar KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë, lidhur me ankesën. Ankesa ka të bëjë me piken 1, 2, dhe 4 të Vendimit që i referohen aprovimit të procedurave interne për faturimin e konsumatorëve pa ujëmatës.

BAZA JURIDIKE

1. Neni 34 i Ligjit për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave (më tutje: Ligji Nr. 03/L-086) dhe neni 10 i procedurës së punës.

PËRMBËLEDHJA E FAKTEVE

2. Përmes vendimit të datës: 27, 08, 2012, ZRRUK, konstaton se: I. Aprovon procedurat interne për aplikim nga KRU, "Radoniqi", Sh. A. Gjakovë, për faturim të konsumatorëve pa ujëmatës, ose me ujëmatës jo funksional dhe implementim të Rregullës ZRRUM, R - 03 / U & K, me qëllim të ngritjes së eficiencës së shërbimeve të veta. II. Inicimi i faturimit sipas pasqyrës Nr 1 do të fillojë të aplikohet nga: 01. 09. 2012, duke iu përmbajtur procedurave dhe Rregullës ZRRUM R - 03 / U & K. III. Aprovohet afati kohor për eliminimin e faturimit të konsumatorëve ekzistues pa ujëmatës ose me ujëmatës jo funksional, duke filluar me implementimin e pasqyrës Nr 1 për ngarkesë shtesë të konsumit mesatarë mujor për konsumatorët që nuk përmbushin kërkesat e kompanisë për instalim, ose zëvendësim të ujëmatësve jo funksional - përgatitur nga KRU, "Radoniqi", Sh. A. Gjakovë, nga: 01. 09. 2012 gjerë me: 31. 12. 2012. Nëse kompania konsideron se nuk mund të përmbush kërkesat e ZRRUM-it për instalim të 2000 ujëmatësve të konsumatorët shtëpiak të identifikuar si të tillë gjerë në fund të këtij viti kalendarik e njëjta mund të parashtrojë kërkesë në Rregullator për tu liruar nga ky standard për një numër të caktuar të konsumatorëve dhe për një periudhë të caktuar kohore. IV. Për konsumatorët e rij të vazhdohet me procedurat sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi gjerë në eliminimin e faturimit të tyre pa ujëmatës ose me ujëmatës jo funksional. V. Çdo standard i Rregullës R - 03 / U & K, datë: 31. 04. 2011, i cili është në fuqi e që nuk mund të përmbushet nga kompania, duhet të kërkohet lirim për të njëjtin nga ZRRUM për periudhë të caktuar kohore.
3. Ndaj këtij vendimi të ZRRUK-it, KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë, me datë: 07. 09. 2012 ka parashtuar ankesë në ZRRUK. Në ankesë, KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë pohon se, *"Me qenë se ZRRUM-i ka përfunduar procesin e llogaritjes së paushallit për kompaninë tonë, ne si kompani nuk pajtohemi me sasinë e aprovuar nga ZRRUM-i për faturimin e konsumatorëve pa ujëmatës"*. Po ashtu në ankesë, KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë, pohon se, *"Kompania në vazhdimësi është duke instaluar ujëmatës për të eliminuar paushallin, mirëpo sasia e aprovuar nga ana e juaj nuk është në interes të kompanisë pasi rrit konsumatorët paushall në terren"*. Së bashku me ankesë, KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë, dërgon formën e re të llogaritjes së paushallit. Sipas kësaj forme, I. Konsumatorët shtëpiak: apartamente 20 m³ në muaj; shtëpitë urbane 45 m³ në muaj; shtëpitë rurale 80 m³ në muaj. II. Konsumatorët komercial / industrial: dyqanet e vogla 15 m³ në muaj; restorantet 101 m³ në muaj; hotelet 45 m³ në muaj; prodhuesit industrial 938 m³. III. Konsumatorët institucional: shkollat 167 m³ në muaj; spitalet 2576 m³; shtëpitë e shëndetit 146 m³ në muaj; gjykata 59 m³ në muaj. Ankesa e KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë, përfundon me kërkesën që, *"...të merrni parasysh, pasi me formën e aprovuar nga ana e juaj nuk mund të garantojmë eliminimin e konsumatorëve që faturohen paushall pa ujëmatës. Arsyeja pasi faturimi i ulët vjen deri te prishja e ujëmatësve"*.

4. Në përgjigjeje të kësaj ankese, në letrën e dërguar me datë: 14. 09. 2012, me temë: *Implementimi i Rregullës ZRRUM R - 03 / U & K për eliminim të faturimit paushall*, ZRRUK sqaron, se, lidhur me ankesën tuaj për mospajtim me sasinë e ujit të aprovuar për faturim të konsumatorëve pa ujëmatës sipas procedurave të aprovuara nga ZRRUM me Nr 399, datë: 30. 08. 2012, kemi analizuar edhe një herë të dhënat tuaj duke i krahasuar me Rregullën ZRRUM R - 03 / U & K dhe kemi arrit të konkludimi se ankesa juaj është e paqëndrueshme dhe se kompania e juaj duhet t'i përmbahet rregullës në fjalë dhe akteve tjera rregullative të aprovuara nga ZRRUM për faturim të konsumatorëve pa ujëmatës gjerë në eliminimin e plotë të faturimit të tillë. Më tutje, në letër ZRRUM sqaron se, atë që e theksuam më lartë e mbështesim në Rregullën ZRRUM R - 03 / U & K, neni 37, faturimi pa ujëmatës pikat 37. 1, nën pikat a dhe b, dhe Udhëzimin ZRRUM, bashkangjitur si Shtojcë në Rregullën ZRRUM R - 03 / U & K, pastaj procedurat e aprovuara nga ZRRUM sipas vendimit të datës 29. 08. 2012 dhe pasqyrës nr. 1. Në fund të letrës, ZRRUM konstaton, "...kërkohet nga ju të implementoni procedurat e aprovuara nga rregullatori gjerë në eliminimin e plotë të faturimit të paushallit sipas shkresës sonë nr. 399".
5. Pas kësaj letre, me datë: 09. 10. 2012, KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë, ka parashtruar ankesë në Komisionin Shqyrtues, me temë: *Ankesë për Llogaritjen e Paushallit*.

PREZANTIMI I ARGUMENTEVE

6. Komisioni Shqyrtues në takimin e mbajtur me datë: 24. 10. 2012, sipas nenit 34, pika 34. 4, të Ligjit Nr. 03/L-086, ka vendosur të ofrojë mundësinë përfaqësuesit të ZRRUK-it dhe KRU, "Radoniqi", Gjakovë, në Komisionin Shqyrtues të dëgjojë qëndrimet e tyre lidhur me vendimin dhe ankesën.
7. Në dëgjimin e mbajtur me datë: 25. 10. 2012, përfaqësuesi i ZRRUK-it e arsyetoi vendimin duke pretenduar se, "...ankesa e parashtruar nuk ka bazë për kontest pasi ZRRUK i ka respektuar në tërësi rregullat dhe ka vepruar konform legjislacionit të aplikueshëm. Arsyetimi se shumtë e dala si mesatare e harxhimit për kategori nuk është arsye për të përmbysur tërë procedurën dhe mendoj se ka pasur paqartësi edhe rreth rregullave të aplikimit". Sipas përfaqësuesit të ZRRUK-it, KRU, "Radoniqi", Gjakovë, Sh. A, duhet të kuptojë mirë vendimin e ZRRUK-it.
8. Pas këtyre sqarimeve, përfaqësuesi i KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë kërkoi nga Komisioni Shqyrtues t'i mundësohet të konsultohet edhe njëherë me kompaninë para se me thanë fjalën përfundimtare.
9. Kështu në takimin e mbajtur me datë: 30. 10. 2012, përfaqësuesi i KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë, pohoi se, "KRU, 'Radoniqi', Sh. A, Gjakovë njofton Komisionin Shqyrtues se tërhiqet nga ankesa e bërë me datë: 05. 09. 2012 dhe 25. 09.

2012 për Llogaritjen e Paushallit". Më tutje në letrën dërguar Komisionit Shqyrtues, KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë, sqaron se,

"Pas mbajtjes së disa takimeve në ZRRUK, me Komisionin Shqyrtues ka marr vendim të tërhiqet nga ankesa e bërë". Arsyeja e "...tërheqjes është se tarifat e paushallit të aprovuara nga ZRRUK sipas vendimit të datës: 29. 08. 2012 janë të pranueshme, dhe do të implementohen sipas procedurave nga Rregullatori gjerë në eliminimin e plotë të faturimit paushall për konsumatorët që marrin shërbimet e ujësjellësit pa ujëmatës".

VLERËSIMI

10. Komisioni shqyrtues vlerëson se ankesa e KRU, "Radoniqi", Gjakovë, Sh. A, është bërë brenda afatit kohor ligjor prej 15 dite pune dhe si e tillë është e pranueshme.
11. Komisioni Shqyrtues duke u bazuar në shkresën e KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë, dorëzuar në Komisionin Shqyrtues me datë: 30. 10. 2012 nga përfaqësuesi i saj në Komisionin Shqyrtues, dhe në prezantimin e përfaqësuesit të KRU, "Radoniqi", Sh. A, Gjakovë, për tërheqje nga ankesa dhe pranim i vendimit të ZRRUK-it.

PËR KËTO ARSYE

12. Komisioni Shqyrtues në pajtim me nenin 34. 4 të Ligjit Nr 03 / L - 086 dhe me nenin 10 të procedurës së punës:

VENDOS

1. Mbetet në fuqi vendimi i ZRRUK-it për aprovim të procedurave interne i datës: 27. 08. 2012, si dhe letra për implementimin e këtij vendimi e datës: 14. 09. 2012.

Këshillë juridike: Në bazë të nenit 35 të Ligjit Nr. 03/L-086, palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashetrojnë ankesë në Gjykatën Kompetente për shqyrtim brenda një (1) muaji nga data kur ofruesit të shërbimeve i është dorëzuar me shkrim vendimi përkatës nga Komisioni Shqyrtues.

Kryesuesi i Komisionit Shqyrtues:

Ylber Aliu
